



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më 04.09.2025

MBLEDHJA Nr. 36,
Datë 09.09.2025, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 09.09.2025, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 36 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 01.09.2025.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Gusht 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “AMEL ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN VALUE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN VALUE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “NRG POWER” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
7. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 160, datë 18.07.2025, “Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
8. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 148, datë 08.07.2025, “Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SUNPRO” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
9. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI